



SBASHK Arsimimi sot

Prill, 2023

Gazeta elektronike

Pjesëmarrje e madhe e mësimeve në trajnimet e organizuara nga SBASHK Kontribut me vlerë për ngritjen e cilësisë në arsim



Në pritje të shpalljes së thirrjes për aplikim nga MASHTI lidhur me programet e trajnimeve, në SBASHK është bërë një analizë përmbajtjesore dhe një vlerësim i rrjedhës së trajnimeve të shumta që sindikata jonë ka organizuar duke u bazuar në vullnetin e anëtarësisë kudo në komunat e Kosovës. Shifrat dhe faktet flasin se SBASHK-u ka bërë një punë të jashtëzakonshme në realizimin e këtij aktiviteti. Për këto arritje meritore ... (faqe 4)

SBASHK në mbështetje të kërkesave të Sindikatës së Re të KEK-ut

**Jasharaj –Ju me sakrificat
të mëdha po i jepni dritë
Kosovës**


Të premten e 28 prillit Sindikata
e Re e Korporatës ... (faqe 6)

Bisedë me kryetarin e
SBASHK-ut Rrahman
Jasharaj
Heshtja e një majit



Për gazetën tonë "Arsimimi
sot" të muajit prill ... (faqe 3)

U mbajt takimi i Kryesisë së SBASHK-ut Angazhim për realizimin e detyrave konkrete



Kryesia e SBASHK-ut vazhdon ... (faqe 5)

BSPK në seminarin e organizuar nga ILO, ITUC dhe
ETUCE

Shënohet Dita e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë



Duke shënuar 28 prillin ... (faqe 5)

Editorial

Me unitet përballohen të gjitha sfidat



Të punësuarit në arsim janë përballur kohëve të fundit me shumë sfida dhe me përpjekje të institucioneve për ta dobësuar forcën sindikale. Institucioneve qendrore u duhen sindikata të heshtura e pa angazhime sindikale sepse ashtu veprojnë e bëjnë ashtu si ju teket dhe as edhe një herë ata nuk mundohen shumë për mirëqenien e punëtorëve. Ata para se të mendojnë një veprim e analizojnë se cili do të jetë reagimi i palës tjetër e në këtë rast testojnë reagimin e të punësuarve përmes sindikatës së tyre. Sindikata aq sa është unike, aq edhe e ka forcën e angazhimit e reagimit. Kur ka unitet të plotë zëri sindikal është i fuqishëm dhe dëgjohet kudo nga opinioni i gjerë.

Sindikata jonë sa herë është plasuar nga kushdo qoftë njëfarë ideje për testin me shkrim të njohurive ka përsëritur publikisht se një gjë e tillë nuk ka ndodhur e as nuk do të ndodh kurrë sepse është degradim dhe nënçmim i njohurive që punëtorët arsimor kanë marrë gjatë studimeve nëpër vite. Kemi reaguar edhe në gjithë situatat tjera dhe sfidat i kemi kaluar më lehtë sepse jemi unik dhe ruajmë besimin e ndërsjellë. Sindikatën nuk duhet duartrokatur vetëm kur me veprimet e saj krijohen benefite e përfitime materiale, por edhe atëherë kur ajo ngrit fuqishëm zërin e kundërshtimit ndaj tendencës për degradim, për shkeljen e të drejtave në punë dhe kur vazhdon publikisht ta mbroj figurën e mësuesit që individë e institucione mundohen ta zbehin. Të punësuarit në arsim, që nga çerdhet e deri në universitet e dinë se nuk kishte, nuk ka dhe nuk do të ketë zë tjetër mbrojtës për ta.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Heshtja e një majit



Për gazetën tonë “Arsimimi sot” të muajit prill biseduam me kryetarin SBASHK-ut Rrahman Jasharaj për çështjet që lidhen me aktivitetet sindikale, por edhe për heshtjen e një majit.

Arsimimi sot:

Cilat janë disa nga aktivitetet e zhvilluara të SBASHK-ut kohëve të fundit?

Jasharaj:

Një aktivitet që do të veçoja dhe që ka krijuar emocione është ai me veprimtarët sindikalë, të cilët me vite e dekada, krahas angazhimeve në procesin mësimor, janë dëshmuar edhe me angazhime të vazhdueshme në aktivitetet e shumta sindikale të SBASHK-ut. Ata njerëz na janë mirënjohës dhe ndjehen mirë sepse e vërtetuan se SBASHK-u nuk harron kurrë angazhimin e tyre sindikal nëpër të gjitha etapat e nëpër gjithë këto vite.

Arsimimi sot:

Cilat janë arritjet në organizimin e trajnimeve ?

Jasharaj:

Arritjet vërtetë janë shumë të mëdha. Shpreh respekt për koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, për stafin qendror, për trajnerët dhe për shumë nga kryetarët e nivelit komunal sindikalë të cilët kanë bërë angazhime të mëdha duke plotësuar kërkesat dhe vullnetin e mijëra anëtarëve e anëtarëve

të SBASHK-ut për pjesëmarrje në të tetë trajnimet e licencuara të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Cili është nga aktivitetet me të cilat është angazhuar stafi i SBASHK-ut?

Jasharaj:

Ka shumë aktivitete dhe unë i përgëzoj gjithë anëtarët e stafit qendror. Tani ata, përveç angazhimeve të përditshme, janë duke bërë parapërgatitjet për organizim të shkëlqyer, ashtu siç kanë bërë viteve të kaluara, të aktivitetit tradicional të pushimit në bregdetin shqiptar të qindra anëtarëve të SBASHK-ut nga e tërë Kosova.

Arsimimi sot:

Ishte i heshtur një maji ?

Jasharaj:

Nuk ishte krejt i heshtur. Para një majit ndodhi protesta e Sindikatës së Re të KEK-ut, po edhe më një maj kishte protesta të disa sindikatave. Mbase, është pritur një protestë e madhe nga BSPK-ja, por ne në Kryesinë Ekzekutive të BSPK-së nuk kemi marrë një vendim të tillë. Vitin e kaluar kishim organizuar shumë protesta e greva dhe mendojmë të kemi një heshtje, që nuk do të thotë se do të vazhdojë përgjithmonë. Tek e fundit nuk mjafton të bëhet një protestë, sa për të thënë, më 1 maj e pastaj të ketë heshtje tërë vitin. Heshtjen duhet thyer shpesh gjatë një viti kur institucionet heshtin ndaj kërkesave legjitime të anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Ndonjë këshillë për të punësuarit në Kosovë?

Jasharaj:

Të punësuarit në Kosovë në të gjithë sektorët duhet të jenë të angazhuar në sindikatat e tyre dhe të tejkalojnë çdo sfidë duke ruajtur unitetin. Ta forcojnë sindikalizmin dhe ata që kanë harruar të reregjistrohen në eKosova sindikatat ishin dhe janë zëri i tyre i vetëm dhe ai zë duhet të mbetet i fuqishëm.

Gjatë muajit

Pjesëmarrje e madhe e mësimeve në trajnimet e organizuara nga SBASHK
Kontribut me vlerë për ngritjen e cilësisë në arsim

Në pritje të shpalljes së thirrjes për aplikim nga MASHTI lidhur me programet e trajnimeve, në SBASHK është bërë një analizë përmbajtjesore dhe një vlerësim i rrjedhës së trajnimeve të shumta që sindikata jonë ka organizuar duke u bazuar në vullnetin e anëtarësisë kudo në komunat e Kosovës.



Shifrat dhe faktet flasin se SBASHK-u ka bërë një punë të jashtëzakonshme në realizimin e këtij aktiviteti. Për këto arritje meritore janë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror, trajnerët dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal.



Bazuar në raportet dhe shënimet e regjistrat e mbajtur në SBASHK shihet se në të tetë trajnimet e licencuara të SBASHK-ut nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimeve kanë marrë pjesë më shumë se 18 000 punëtorë arsimorë, anëtarë të SBASHK-ut. Në këto trajnime ata janë përfshirë bazuar në vullnetin që kanë shprehur përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal,

të cilët kanë dorëzuar listat në SBASHK dhe pastaj janë bërë gjithë përgatitjet dhe ky aktivitet ka pasur rrjedhë të mbarë.



Cili do nga trajnimet “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”, “Mësime dhe gjuhë dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”, “Roli i aktiviteteve kreative në mësime dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore”, “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar”, “Roli i mësimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës,” kanë zgjuar interesim të madh te punëtorët arsimor, të cilët kanë shprehur vazhdimisht respekt për SBASHK-un që po organizon një aktivitet të tillë dhe kanë falënderuar edhe trajnerët, të cilët ishin të përkushtuar me qëllim që trajnimet të kenë rrjedhë të mbarë dhe të arrijnë qëllimin.




SBASHK-u duke respektuar vullnetin e punëtorëve arsimorë do të aplikojë edhe në thirrjen e radhës me disa programe trajnimesh për të vazhduar me këtë aktivitet edhe në të ardhmen.

U mbajt takimi i Kryesisë së SBASHK-ut Angazhim për realizimin e detyrave konkrete

Kryesia e SBASHK-ut vazhdon me takimet e rregullta për të realizuar detyrat konkrete brenda kompetencave të saj. Kryesia në takimin e fundit ka debatuar për situatën aktuale duke analizuar edhe debatet dhe qëndrimet nga takimet e rregullta me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve. Është debatuar edhe për organizimin e suksesshëm të shumë trajnimeve bazuar në vullnetin e anëtarësisë në shumë komuna të Kosovës duke vlerësuar se falë përkushtimit të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafit qendror, kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe përkushtimit të trajnerëve janë shënuar rezultateve të larta në organizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm. Në kuadër të këtij takimi është debatuar edhe për rrjedhën e reregjistrimit në eKosova për të ardhur në përfundim se po vazhdohet me reregjistrimin, edhe pse ky proces po përcillet edhe me vështirësi dhe lëshime në këtë platformë.

Kryesia duke analizuar fillimin e përgatitjeve për realizimin e aktivitetit tradicional të pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarësisë së SBASHK-ut në bregdetin shqiptar ka përcaktuar edhe kriteret për përzgjedhjen e pushuesve me të cilat ka informuar kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve. Kryesia ka përkrahur vendimin nga takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve për caktimin e afatit të dorëzimit të listave emërore me shënimet e duhura për pushuesit dhe ka autorizuar koordinatorin për organizim të brendshëm që të vazhdohet me përgatitjet dhe me caktimin e përgjegjësve të autobusëve të përkujdesjes për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.



BSPK në seminarin e organizuar nga ILO, ITUC dhe ETUCE Shënohet Dita e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Duke shënuar 28 prillin Ditën e Shëndetit dhe të Sigurisë në Punë, Organizata Botërore e Punës (ILO) bashkë me Konfederatën e Sindikatave (ITUC) dhe Unionin e Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) kanë organizuar në Shkup seminar për përfaqësuesit e Konfederatave Sindikale nga shtetet e Ballkanit Perëndimor.



Në këtë ngjarje të veçantë sindikale BSPK-ja është përfaqësuar nga kryetari Atdhe Hykolli dhe anëtari i Kryesisë ekzekutive të kësaj Konfederate Ymer Ymeri. Tema bosht e këtij seminari ishte “Përdorimi strategjik i makinerisë mbikëqyrëse të ILO-s në dritën e njohjes

së standardeve të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë si një e drejtë themelore në punë”. Pjesëmarrësit në këtë seminar përmes diskutimeve kanë kujtuar se punëdhënësit janë ata që duhet të parandalojnë rrezikun nga aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës. Ata kanë bartur përvojat nga vendet e tyre lidhur me këtë tematikë e po ashtu në kuadër të këtij aktiviteti kanë zhvilluar edhe takime me kolegët nga shtete të ndryshme duke bashkëbiseduar për çështjet aktuale sindikale dhe duke u angazhuar që të forcohet bashkëpunimi mes Konfederatave sindikale të shteteve të Ballkanit Perëndimor.



SBASHK në mbështetje të kërkesave të Sindikatës së Re të KEK-ut **Jasharaj –Ju me sakrifica të mëdha po i jepni dritë Kosovës**

Të premten e 28 prillit Sindikata e Re e Korporatës Energjetike të Kosovës ka organizuar protestë duke shpalosur kërkesat legjitime të punëtorëve, që me mund e sakrifica angazhohen që Kosovës t'i sigurojnë dritë. Protestuesit janë nisur nga Sheshi “Zahir Pajaziti” për t'u ndalur para ndërtesës së Qeverisë.



Kryetari i kësaj sindikate Nexhat Llumnica ka ngritur zërin e protestës së arsyeshme duke shpalosur kërkesat legjitime të punëtorëve të kësaj Korporate. Pjesë e kësaj

proteste kanë qenë edhe kryetari i këshillit Drejtues të BSPK-së Ali Gashi, nënkryetari Skender Lushtaku dhe kryetari i SBASHK-ut e anëtar i Kryesisë së BSPK-së Rrahman Jasharaj.

Kryetari Jasharaj duke shprehur solidaritetin e SBASHK-ut me Sindikatën e Re të KEK-ut dhe me pjesëmarrësit e protestës ka deklaruar se sjell mesazhin e punëtorëve të arsimit të cilët janë në mbështetje të kërkesave legjitime të punëtorëve që me mund e sakrifica angazhohen për t'i siguruar dritë Kosovës. Protestuesit me brohoritje e duartrokitje kanë përshëndetur kryetarin Jasharaj duke e falënderuar për mbështetjen dhe pjesëmarrjen në këtë protestë.

Një numër i madh i medieve e kanë përcjellë vazhdimisht këtë protestë e cila ka përfunduar në mënyrë të qetë e me paralajmërimin për veprime të tjera sindikale nëse kërkesat nuk fillojnë së realizuari.

Filluan me kohë përgatitjet për një aktivitet të veçantë **Edhe këtë vit qindra anëtarë të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar**



Foto nga Arkivi

kryesia ka përcaktuar edhe kriteret për përzgjedhjen e pushuesve që do të bëjnë shoqatat sindikale në

SBASHK-u edhe këtë vit do të vazhdojë me traditën e mirë të organizimit të pushimeve në bregdetin shqiptar për një numër të konsideruar të anëtarëve nga e tërë Kosova. Lidhur me këtë aktivitet është debatuar në takimet me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve dhe

institucionet arsimore, që e kanë radhën këtë vit për të caktuar pushuesit nga radhët e tyre.

Me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë, sikur edhe viteve të kaluara, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror kanë nisur nga tani me përgatitjet dhe në koordinim me veprimtarët sindikalë do të pranojnë me kohë listat me të përzgjedhurit në mënyrë që pastaj ata të sistemohen nëpër tri grupet e pushuesve. Grupi i parë do ta nis këtë aktivitet më 15 qershor dhe do të jetë i përbërë nga pushuesit që përzgjidhen nga Universitetet dhe nga ata që kryejnë obligimet e tyre edukativo-arsimore deri në atë kohë. Grupi i dytë parashihet të nis pushimet më 25 qershor e për t'u përmbyllur ky aktivitet tradicional me grupin e tretë të pushuesve.

BSPK mysafire në Kongresin e Konfederatës turke Memur-Sen **Aktivite të shumta në këtë ngjarje të madhe të sindikatave turke**



Kryetari i BSPK-së Atdhe Hykolli bashkë me anëtarin e kryesisë ekzekutive Ymer Ymeri morën pjesë në Kongresin e “Memur Sen” që është konfederata më e madhe e sindikatave turke me miliona anëtarë.

Kryetari i “Memur Sen” Ali Jalcin, ka zhvilluar takime me delegacionet pjesëmarrëse duke iu dëshiruar mirëseardhje.

Përfaqësuesit e BSPK-së kanë pasur takime me shumë

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

prej kolegëve të tyre nga shtete të ndryshme dhe me mikpritësit duke bashkëbiseduar me sfidat sindikale të kohës dhe për mundësitë e bashkëpunimit mes Konfederatave dhe sindikatave në të ardhmen.

Në hapje të kësaj ngjarje të veçantë ka marrë pjesë edhe presidenti i Turqisë Taip Rexhep Erdoan, i cili ka përshëndetur pjesëmarrësit duke i dëshiruar sukses punimeve të Kongresit.

Mikpritësi në kuadër të këtij aktiviteti ka paraparë edhe takime të ndara me pjesëmarrësit dhe vizita në pjesët turistike të Turqisë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture